

Njoftim nga takimi i kryetarit me drejtorët e komunës
QEVERIA KOMUNALE NIS HARTIMIN E RREGULLORES PËR KUFIZIMET NË QENDRËN HISTORIKE

15 mars 2013, Prizren

EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Transparenca online e Komunës së Prizrenit" gjatë kësaj jave ka marrë pjesë në mbledhjen e radhës të kryetarit të komunës, Ramadan Muja me drejtorët komunal, ku janë miratuar disa konkluzione.

Konform Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit nr.04/L-66 Komuna e Prizrenit obligohet që brenda dispozitave të Ligjit, të hartojë rregullore për aktivitetet e kufizuara dhe të ndaluara në brendinë e qendrës historike të Prizrenit.

Me këtë rast qeveria komunale e Prizrenit ka formuar komisionin shtatë anëtarësh nga sektorë të ndryshëm, që do të merret me hartimin e rregullores. Në përbërjen e këtij komisioni do të jenë dy anëtarë nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, nga një anëtar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria për Kulturë, Drejtoria për Turizëm, Inspektorati, gjithashtu edhe një anëtar nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës.

Me kërkesë të Drejtorisë për Urbanizëm, ekzekutivi lokal ka lejuar shpalljen e tenderit për hartimin dhe restaurimin e objektit-shtëpisë së Ymer Prizrenit, sikurse edhe lejimin e mjeteve për pagesën e pëlqimit të dhënë nga e KEK-ut për Kompleksin Europa, dhe atë kyçjen e rrymës në objekt.

Drejtorisë për Shërbime Publike i është aprovuar kërkesa për shpallje të tenderëve për ndërtimin e disa rrugëve lokale dhe mureve mbrojtëse, me participim në rr."Hysni Morina 1", muri mbrojtës në fshatin Landovicë dhe rrugët lokale në fshatin Hoçë e Qytetit, sikurse edhe shpalljen e tenderit për ndërtimin e kanalizimit fekal në lagjen Arbana, ku kjo e fundit kap shifrën rreth 50 mijë euro.

Gjithashtu ka kaluar edhe kërkesa për aktvendim për emërim të komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe përgaditjen e lëshimit të Lejeve Mjedisore Komunale, si dhe autorizimin e zyrtarit për nënshkrimin e këtyre lejeve e që do të ketë për qëllim zbatimin e ligjshmërisë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Ka kaluar edhe propozimi i Drejtorisë për Shëndetësi për bërjen e analizave bakteriologjike-kimike të ujit të pijës në 40 fshatra të Komunës së Prizrenit.

Ekzekutivi lokal ka miratuar edhe kërkesat e Drejtorisë së Turizmit dhe të Zhvillimit Ekonomik, reth lejimit të shpalljes së tenderit për mirëmbajtjen e muzeut të hapur arkeologjik, gjithashtu edhe shpalljen e tenderit për dizajnimin dhe shtypjen e materialeve promovuese e që do të përdoren për joshje të vizitorëve të huaj, mundësinë e qasjes më të lehtë në pikat turistike, etj.

Drita e gjelbërt i është dhënë edhe Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për lejimin e shpalljes së tenderit për vlerësimin dhe hartimin e projektit për kulmin e Shtëpisë së Kulturës në fshatin Zhur, botimin e monografisë "Feniksët e Lirisë-15", përkrahjen financiare për Shoqatën e pedagogëve të kulturës fizike në Prizren për pjesëmarrje në kampionatin botëror të sportit shkollor në basketboll që mbahet në Qipro.

Në këtë takim Qeveria komunale me kërkesë të Drejtorisë për Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka lejuar shpalljen e tenderit për furnizim me 60 makina mjelëse për fermerë (parallogaria 25 mijë euro), hapjen e tenderit për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizimin e qytetit të Prizrenit (parallogaria 30 mijë euro).

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

*Projekti "Transparenca online e komunës së Prizrenit" prej muajit shtator 2012
përkrahët financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*